

1. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja është një nga funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë. Qëllimi i saj është të ushtrojë në vazhdimësi kontroll të mjaftueshëm mbi bankat dhe subjektet e tjera që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj. Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoritet mbikëqyrës, synon të sigurojë ruajtjen e shëndetit të bankave, stabilitetin e sistemit bankar e financiar, parandalimin e krizave në këtë sektor, si dhe mbrojtjen e depozituesve.

Në përmbushje të misionit të saj, mbikëqyrja ushtron **tre funksione kryesore**: licencimin e subjekteve financiare, rregullimin e veprimtarisë së subjekteve dhe kontrollin e kësaj veprimtarie në vazhdimësi. Për realizimin e këtyre funksioneve janë ngritur struktura të posaçme si dhe janë ndërtuar procese pune për të maksimizuar realizimin sa më efektiv të tyre.

Funksioni i licencimit mbështetet në një tërësi rregullash minimale, të cilat duhet të respektohen nga subjektet që licencohen. Këto rregulla lidhen me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë. Funksioni i licencimit ushtrohet edhe përgjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së subjektit për çështje që lidhen me ndryshimin e natyrës së veprimtarisë apo me atë të strukturave të ngritura.

Funksioni i rregullimit mbështetet në hartimin dhe zhvillimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm, të mishëruar në një spektër të gjerë aktesh nënligjore. Kuadri rregullativ synon të përcaktojë kriteret minimale të natyrës sasiore dhe cilësore, të cilat mundësojnë hyrjen në treg të subjekteve të shëndosha dhe me potencial zhvillimi, si edhe monitorimin dhe vendosjen e veprimtarisë së tyre mbi një shtat të qëndrueshëm. Kuadri rregullativ është në ndryshim të vazhdueshëm për t'iu përgjigjur dinamikës së zhvillimit të veprimtarisë së subjekteve dhe ambientit ku ato veprojnë, si edhe përshtatjes me ndryshimet e praktikave më të mira ndërkombëtare në sferën e rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Funksioni i kontrollit mbështetet në hartimin e një cikli të vazhdueshëm mbikëqyrjeje mbi subjektet, që zbatohet nëpërmjet një koordinimi të balancuar të inspektimeve në vend të veprimtarisë së subjekteve dhe analizave nga jashtë të informacionit të dërguar prej tyre, në përputhje me natyrën, rëndësinë, problematikën dhe shkallën e kompleksitetit të subjekteve. Për realizimin e këtyre funksioneve, mbikëqyrja bazohet në analizën e sërë treguesish sasiorë, për të cilët përcaktohen edhe disa vlera reference, si dhe në shqyrtimin e punës së strukturave drejtuese të subjekteve në administrimin e veprimtarisë së përditshme. Bazuar në vlerësimet e kryera përcaktohet profili i rrezikut të subjektit, evidentohen mangësitë e punës për kryerjen e një veprimtarie të shëndoshë, lihen rekomandime për përmirësime, apo kur vlerësohet e nevojshme merren dhe masa mbikëqyrëse dhe ndëshkimore, të cilat ndiqen në vijimësi.

